Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**18.12.2023**	**21.12.2023**	**2023/1009**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.12.2023, OE " WOOD COMPANY " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1009, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Petrol Company" SH.P.K; Bek Fluids L.L.C .” lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me lend djegese - Dru dhe Pelet LOT 1- Furnizim me lend djegese - Dru LOT 2- Furnizim me lend djegese - Pelet” me nr. të prokurimit: "635-23-8135-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës:furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 340.000.00 €. LOT 2- Furnizim me lënd djegëse- Pelet Vlera: 100.000.00 Euro.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0798 i dt:16.11.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese*

Ne me dt.29.11.2023 përmes platformës elektronike E-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, ku autoriteti kontraktues pas rivlerësimit e ka rekomanduar për kontratë grupin e OE **Petrol Company - SH.P.K. & Bek Fluids L.L.C.**, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm.

Fillimisht ju sqarojmë se në njoftimin mbi vendimin e dt.05.10.2023 AK-ja na kishte rekomanduar neve për kontratë dhe OE tani të rekomanduar për kontratë e kishte eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, me arsyetimin se i njëjti ka prezantuar kontrata të cilat nuk kanë të bëjnë me natyrën e kërkesës së dosjes së tenderit.
I njëjti OE kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues ja kishte refuzuar dhe pastaj kishte vazhduar me ankesë në OSHP.
Në lidhje me ankesën e të njëjtit është lëshuar një ekspertizë me nr.798/23, ku ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se lënda duhet të kthehet në rivlerësim dhe të kërkohen sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së. Autoriteti kontraktues është pajtuar me ekspertizën dhe ka kthyer lëndën në rivlerësim, ndërsa gjatë rivlerësimit e njëjta i ka kërkuar sqarime shtesë OE të rekomanduar për kontratë.

Nga qasja që kemi pasur në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe sqarimet të cilat i njëjti i ka bërë, kemi ardh në përfundim se i njëjti është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, përkatësisht kërkesën "*Kërkesa 1 Për (LOT-2) Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat te natyres se ngjajshme në vler prej 150.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat*", ku si dëshmi dokumentare për këtë kërkesë është kërkuar *"Dëshmia 1-Për (LOT-2) Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosies së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve".*

OE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertë ka prezantuar një listë të furnizimeve të realizuara të gjitha me kompani private dhe të njëjtave ju figuron titulli furnizim me lëndë djegëse dhe pelet, mirëpo në këto kontrata nuk ka pasur fare furnizim me pelet dhe këtë do ta vërtetojmë me faktet e mëposhtme:

I njëjti OE pasi që AK-ja i ka kërkuar sqarime shtesë i ka prezantuar disa fatura dhe një kontratë me kompaninë DHF company SHPK, e cila si veprimtari ka shitjen e derivateve.
Ne kemi dyshimet tona se kontrata e prezantuar e cila është lidhur me dt.11.05.2019 është kontratë e cila është nënshkruar vetëm për derivate dhe jo edhe për pelet, pra dyshojmë që e njëjta është kontraktë fiktive.

Kur analizohen faturat e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë shihet se çmimi i peletit për një ton të paguar ka qenë 250 euro maksimumi, ndërsa në kohën kur janë lëshuar faturat, çmimi i tregut për një ton pelet ka qenë minimumi 500 euro. Ndërsa në nenin 7 të kontratës së prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, shkruan se gjatë afatit të kësaj kontrate në rast të ndryshimit të çmimeve në treg, kontraktuesit janë marr vesh që çmimet e kësaj kontrate mund të ndryshohen sipas lëvizjes së çmimeve në treg.

Nga faktet e lartcekura, ne kemi dyshimet tona se të njëjtat fatura janë fiktive dhe janë fatura të cilat nuk kanë të bëjnë fare me furnizim me pelet.
Ky dyshim i yni është edhe më i madh kur analizohen transaksionet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, ku asnjëri nga transaksionet nuk përputhet me faturat e lëshuara për kompaninë DHF.

Pra në asnjërin nga transaksionet përveç që nuk shënon numri i faturës, nuk shënon gjithashtu as lloji i pagesës. P.sh. tek pagesat e derivate shënon pagës për derivate, ndërsa për pelet nuk ceket askund, andaj këtu shtohen edhe më shumë dyshimet se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka bërë furnizim me pelet fare.

Dyshimet tona janë edhe më të mëdha, për faktin se i njëjti OE ka ofertuar edhe në disa tender të tjerë tek autoritet të ndryshme dhe tek dokumentet e të njëjtit i cili i ka dorëzuar edhe në tenderë të tjerë, ku në asnjërin nga këta tender nuk kanë ekzistuar këto dokumente të cilat i ka prezantuar tani me sqarime shtesë ky OE. Pra kur kemi parasysh faktin se faturat e lëshuara janë në fillim të këtij viti dhe kontrata është e vitit 2019, atëherë i njëjti do ti kishte prezantuar edhe në tenderët e tjerë.

Dyshimet tona janë të bazuara edhe në njoftimin mbi vendimin e dt.05.10.2023, ku në aktivitetin e prokurimit : *"Furnizim me lënd djegëse – Dru dhe Pelet. LOT 1- Furnizim me lënd djegëse – Dru. LOT 2- Furnizim me lënd djegëse – Pelet"*, me nr. të prokurimit 635-23-8135-1-1-1, i inicuar nga Komuna e Pejës, në të njëjtin vendim është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit grupi i cili është rekomanduar për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se: *O.E: Grup i Operatorëve Ekonomik Petrol Company - SH.P.K.; Bek Fluids L.L.C. Gjate Vlersimit te ofertes se juaj nga komisioni vlersues ka konstatuar se ju nuk keni përmbushur kriteret e kerkuara ne DT dhe NJ,K, Eleminimi 1:*
Ne dosien e tenderit jan kerkuar Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat te natyres se ngjajshme në vler prej 150.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.
Ndersa ne oferten e juaj te dorzuar me daten 13.09.2023 keni prezantuar kontrata tjera qe nuk kan te bejen me natyren e punes se furnizimit me PELET apo DRU siq eshte kerkuar nga A.K ne D,T andaj me keqardhje ju njoftojm se oferta juaj eshte e pa pergjegjeshme dhe eliminoheni nga ky A.P".

Gjithashtu edhe vet autoriteti kontraktues e ka cilësuar si të papërgjegjshëm të njëjtin OE në lidhje me kontratat e prezantuara, mirëpo që çuditërisht tani në njoftimin e tanishëm e ka rekomanduar për kontratë.

Kërkojmë nga ana e OSHP-së që ti analizoj në tërësi dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe të bëj verifikimin e këtyre dëshmive të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe pretendimeve tona ankimore, sepse në të kundërtën ne jemi të detyruar të vazhdojmë me ankesa edhe në instancat tjera më të larta, pasi që faktet e prezantuara nga ana jonë, e tregojnë qartë papërgjegjshmërinë e OE të rekomanduar për kontratë.

Andaj kërkojmë që të analizohet në tërësi pretendimi ynë ankimor dhe dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, pasi që siç e cekëm ky OE është i papërgjegjshëm.

Ne me dt.06.12.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ku AK-ja e ka cilësuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë arsye konkrete për një refuzim të tillë.
E njëjta në vendimin për refuzim e ka cekur se kanë kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, ku i kanë kërkuar kontratën dhe të gjitha transaksionet bankare që janë bërë në mes të OE të rekomanduar për kontratë dhe kompanisë DHF Company SHPK. Pas prezantimit të dëshmive AK-ja e ka cekur se ceken qartë në fatura dhe transaksione bankare furnizimet me pelet për kompaninë DHF Company SHPK, andaj sipas AK-së pretendimi ynë ankimor është i pa bazuar.

Konstatimi i AK-së se ceket qartë në transaksione furnizimi me pelet, është i paqëndrueshëm për faktin se kur analizohen transaksionet bankare të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë askund nuk figuron që i njëjti ka përfunduar furnizime me pelet. Pra Autoriteti kontraktues me konstatimin e saj mundohet të na vë në lajthitje neve si kompani dhe njëkohësisht edhe OSHP, për

shkak se siç edhe e cekëm askund nuk vërtetohet me transaksionet bankare që i njëjti ka kryer furnizime me pelet. Në transaksione janë të shënuara pagesat për derivate, mirëpo askund nuk shënohet pagesa e peletit ose pagesa e faturave të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë për pelet. Pra dyshimet tona se kontrata e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë dhe faturat, janë fiktive janë të bazuara në faktet e lartpërmendura.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e të gjitha pretendimeve tona ankimore dhe me këtë veprim e njëjta e tregon qartë favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminimin që po i bën kompanisë tonë, duke mos i shqyrtuar pretendimet ankimore.
E njëjta është munduar të devijoj nga pretendimet tona ankimore duke u thirrur vetëm tek sqarimet që i ka kërkuar dhe dokumentet që i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë.

Andaj ne kërkojmë nga ana e OSHP-së dhe ekspertit shqyrtues që ti analizojnë në tërësi të gjitha pretendimet tona ankimore dhe të nxjerrin një vendim/ekspertizë profesionale, pasi që përderisa i njëjti OE është eliminuar në disa procedura paraprake në këtë vit me arsyetimin se nuk posedon dëshmi për kontrata të natyrës së ngjashme, nuk ka asnjë mundësi tani të i prezantoj disa dëshmi të cilat janë të vitit 2019 dhe 2023. Nëse eventualisht i njëjti do ti posedonte këto dëshmi do ti prezantonte edhe në tenderët e tjerë në të cilët ka ofertuar.

Pra dyshimet tona se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar dëshmi fiktive, janë të bazuara në fakte konkrete dhe të qarta, të cilat e dëshmojnë gjendjen faktike.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se me të njëjtin vendim nuk janë shqyrtuar pretendimet tona ankimore në tërësi dhe njëkohësisht vendimi i AK-së nuk është arsyetuar në mënyrë profesionale.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 te LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i përgjegjshëm.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*.
Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "*Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, pasi që është rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm.

Autoriteti kontraktues është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të lëshojë:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **"Wood Company" Shpk për Lot II** si dhe të **ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**,
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **Kërkesa 08 OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit jo me pak se 100,000.00 €;**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Evidenca 08. OE duhet te ofroj deshmi a). Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të ketij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. b). Referencat ose fletet pranimet pranimet teknike në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën**

B28_Ng Dosja e Tenderit për Kontratën Publike Kornizë – Shërbim Me Nje OE 14

Shërbimet e pastrimit të rrobave dhe mbulesave për nevojat e FSK-së
Nr. i prokurimit 217-23-1127-2-1-1& Nr. i brendshëm 217-23-002-2-1-1

			e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive pose raportet e flete pranimeve te furnizime sherbimeve puneve është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera) te lëshuara nga autoriteti i tillë. Për referenca nga institucionet private duhet te dëshmohet qarkullimi bankar origjinal nga banka për vlerën referencës së prezantuar.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Grup i Operatorëve Ekonomik Petrol Company - SH.P.K.; Bek Fluids L.L.C.. është në përputhje me te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne ketë rast sipas kriterit për dhënie te kontratës (Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet) shpallet fitues nga komisioni i vlerësimit, sepse ka ofruar çmimin me te lire Oferta e këtij është € 68,475.00 per LOT 2 dt;17.11.2023

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi me Nr. 2023/0798 i dt:16.11.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" WOOD COMPANY " SH.P.K.**

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, kontratë publike kornizë - furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës 340.000.00 Euro, Vlera Totale e 2 Loteve, LOT 1- Furnizim me lëndë djegëse – Dru Vlera : 240.000.00 Euro, LOT 2- Furnizim me lënd djegëse - Pelet Vlera: 100.000.00 Euro. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Ankesa është parashtruar për (Lot 2)- LOT 2 - "Furnizim me lëndë djegëse – Pelet"

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 29.11.2023.

Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se AK përmes formularit B58 Njoftimit mbi vendimin

e autoritetit kontraktues Komuna e Pejës me dt. 05.10.2023, ka rekomanduar për kontratë për LOT 2-"Furnizim me lënd djegëse – Pelet" operatorin ekonomik tani ankues "Wood Company" sh.p.k.

Pas publikimet të këtij njoftimi, operatori ekonomik "Petrol Compani" shpk parashtron kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues e pastaj ankese në OSHP. **Ekspertja shqyrtuese sqaron** se ka shqyrtuar pretendimet e ankesës me numër 798/23, ku me datë 09.11.2023 është nxjerr raporti i ekspertizës me numër 798/23, pastaj AK nëpërmjet "Deklaratës se pajtueshmërisë me vendimin e ekspertit të OSHP-së" janë pajtuar qe konform nenit 72 të LPP-së të kërkojnë sqarime. Më pastaj, OSHP me datën 16.11.2023 përmes vendimit përfundon procedurën në ketë çështje administrative për shkak të pajtimit të arritur mes palëve AK Komuna e Pejës dhe OE "Petrol Compani" shpk.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues "Wood Company" sh.p.k, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së.

Operatori ekonomik ankues "Wood Company" sh.p.k pretendon se pas qasjes që kanë pasur në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe sqarimeve të cilat i ka bërë AK, pretendojnë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për arsye se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit përkatësisht kërkesat *1.Për (LOT-2) Operatori ekonomik duhet të <u>ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të natyrës se ngjajshme në vlerë prej 150.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.</u>*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Për (LOT-2) Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten <u>referencat</u> ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.

Tutje OE ankues potencon se OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një liste te

furnizimeve te realizuara te gjitha me kompanitë private dhe të njëjtave ju figuron titulli furnizim me lëndë djegëse dhe pelet, mirëpo në këto kontrata nuk ka pasur fare furnizime me pelet dhe këto do ta vërtetojmë me fakte pasi autoriteti kontraktues ju ka kërkuar sqarime OE te rekomanduar për kontrate ky i fundit ka prezantuar disa fatura dhe një kontratë me kompaninë DHF company sh.p.k, e cila si veprimtari ka shitjen e derivateve. OE ankues potencon se ka dyshime se kontrata e prezantuar e cila është lidh me dt.11.05.2019 është kontrate e cila është nënshkruar vetëm për derivate dhe jo edhe për pelet pra dyshojmë që njëjta është kontrate fiktive.

Tutje OE ankues potencon kur analizohen fatura e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë shihet se çmimi i peletit për një ton të paguar ka qene 250 euro maksimumi, ndërsa në kohen kur janë lëshuar faturat çmimi i tregut për një ton pelet ka qene minimum 500 euro. Ne nenin 7 të kontratës se prezantuar nga OE i rekomanduar, shkruan se gjatë afatit të kësaj kontrate në rast të ndryshimit te çmimeve të tregut kontraktuesit janë marrë vesh që çmimet e kësaj kontrate mund te ndryshohen sipas lëvizjes se çmimeve te tregut, dhe dyshojmë se të njëjtat fatura janë fiktive dhe nuk kanë të bëjnë fare me pelet. Po ashtu edhe transaksionet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontrate nuk përputhen me faturat e lëshuara për kompaninë DHF, dhe asnjëra nga transaksionet përveç qe nuk shënon numri i faturës nuk shënon as lloji i pagesës, psh tek pagesat e derivateve shënon pagës për derivate ndërsa për pelet nuk ceket askund andaj këtu shtohet edhe dyshimi se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka bëre furnizime me derivate. Tutje OE ankues shton se dyshimet tona janë edhe për faktin se i njëjti OE ka ofertuar edhe ne disa tender të tjerë tek autoritete kontraktuese dhe tek dokumente e të njëjtit i cili ka dorëzuar në tenderët tjerë nuk kanë ekzistuar këto dokumente.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se përmes raportit me nr. 798/23 i datës 09.11.2023, ka rekomanduar *"AK me rastin e kërkimit të sqarimeve nga OE ankues mund të kërkoj këtë kontratë për qëllim të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve sipas kërkesës së vendosur në dosje së tenderit konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së.",* bazuar ne shkresat e lëndës AK ka kërkuar sqarime me datë 17.11.2023, kurse OE tani i rekomanduar për kontratë ka ofruar sqarime si *"Kontratë për furnizim me Derivate të naftës dhe Peletit", e lidhur me datë 11*.05.2019 në mes të "Petro Company" Sh.p.k. dhe "DHF Company" Sh.p.k. Më këtë kontratë ka bashkangjitur ekstraktin bankar "Qarkullimi në periudhën" të lëshuar nga banka NLB për

periudhën 01.01.2023 – 30.05.2023, pastaj ka bashkangjitur faturat me numër 399/23 e datës 03.02.2023 në vlerë 17,000.00 euro, fatura nr. 405/23 e datës 10.02.2023 në vlerë 22,700.00 euro, fatura nr. 462/23 e datës 24.02.2023 në vlerë 21,600.00 euro, fatura nr. 501/23 e datës 01.03.2023 në vlerë 21,100.00 euro, fatura nr. 621/23 e datës 03.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, fatura nr. 642/23 e datës 08.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, fatura nr. 649/23 e datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro, fatura nr. 689/23 e datës 17.03.2023 në vlerë 21,000.00 euro dhe faturën numër 698/23 e datës 23.03.2023 në vlerë 21,500.00.

Pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve të dorëzuara nga OE "Petrol Company", **ekspertja shqyrtuese** vlerëson se duke pasur parasysh kontratën e lidhur në mes të "Petro Company" Sh.p.k. dhe "DHF Company" Sh.p.k., faturat e lëshuara nga Petrol Company në cilësi të shitësit dhe "DHF Company" në cilësi të blerësit, të cilat përputhen me natyrën e kontratës, si dhe shqyrtimin e ekstraktit bankar me titull "Qarkullimi në periudhën" të lëshuar nga banka NLB për periudhën 01.01.2023 – 30.05.2023, ekspertja shqyrtuese vlerëson se këto fatura përputhen me pagesat të cilat ishin kryer përmes llogarisë bankare, ku rast konkret kemi pagesën me numër të urdhrit 71, datë 08.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro përputhet me vlerën e faturës me numër 642/23 të datës 08.03.2023, pagesa me numër të urdhrit 64 të datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro përputhet me faturën numër 649/23 të datës 15.03.2023 në vlerë 21,900.00 euro, pagesa në vlerë 21,000.00 euro sipas numrit të urdhëresës 62 të datës 17.03.2023 përputhet me faturën me numër 689/23 të datës 17.03.2023 në vlerë 21,000.00 euro, pagesa në vlerë 21,600.00 euro sipas numrit të urdhëresës 86 të datës 24.02.2023 përputhet me faturën numër 462/23 të datës 24.02.2023 në vlerë 21,600.00 euro, po ashtu pagesa në vlerë 23,000.00 euro sipas urdhëresës numër 77 të datës 03.03.2023 përputhet me faturën numër 621/23 e datës 03.03.2023 në vlerë 23,000.00 euro, etj.

Andaj, ekspertja shqyrtuese duke u bazuar në kontratën e dorëzuar, faturat e dorëzuara dhe qarkullimin për periudhën 01.01.2023-30.05.2023, konsideron se këto të dhëna përputhen dhe tejkalojnë vlerën e kërkuar nga "AK *Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të natyrës se ngjajshme në vlerë prej 150.000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë."*

Sa i përket pikës ankimore të OE ankues se kjo kontratë mundet me qenë fiktive për shkak se më herët çmimi i peletit për një ton ka qenë 500 euro, ndërsa faturat e lëshuara janë me çmim

prej 250 euro për një ton pelet, si dhe potencon se këto fatura mund të jenë fiktive, ekspertja shqyrtuese sqaron se në bazë të dokumenteve të dorëzuara në e-prokurim, vlerat e faturave përputhen me vlerat e pagesave në ekstraktin bankar, kurse sa i përket çështjes sa ka qenë çmimi për një ton pelet atëherë dhe në kohën kur janë lëshuar këto fatura, nuk është në kompetencë as të ekspertes as të ndonjë pale tjetër që të shqyrtoj dhe analizoj afarizmin e një biznesi. Kurse, në rast se OE ankues konsideron se është dorëzuar ndonjë dokument i falsifikuar apo dokument fiktiv siç e quan OE ankues, përveç që do duhej që ta dërgonte tek organet kompetente, ka edhe obligim ligjor që të lajmëroj veprën penale tek organet kompetente në rast se mund të argumentoj se çfarë është falsifikuar. Andaj, bazuar në sqarimet e lartpërmendura ekspertja shqyrtuese vlerëson se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nga ana e AK-së është bere konform nenit 59 të LPP-së.

Provë: "Qarkullimi në periudhën" të lëshuar nga banka NLB për periudhën 01.01.2023 – 30.05.2023, "Kontratë për furnizim me Derivate të naftës dhe Peletit", e lidhur me datë 11.05.2019 në mes të "Petro Company" Sh.p.k. dhe "DHF Company" Sh.p.k., si dhe të gjitha faturat e cekura në ekspertizë, që të gjitha këto dokumente gjenden në platformën e e-prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PEJES**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" WOOD COMPANY " SH.P.K.**

Majlinda Bedrolli